



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Ch. Prot 20/5
Dt. 14.02.2025

Nr. 497 Prot.

Tiranë, më 13/02/2025

Lënda: Dërgohen Vendimet e Senatit Akademik

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS ✓
FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT


Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, gjeni bashkëlidhur:

1. Vendimin e Senatit Akademik Nr. 02, datë 10.02.2025, “Për miratimin e kriterëve të pranimit në programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025 – 2026, i përditësuar”;
2. Vendimin e Senatit Akademik Nr. 03, datë 10.02.2025, “Për miratimin e kriterëve të pranimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025 – 2026, i përditësuar”;
3. Vendimin e Senatit Akademik Nr. 04, datë 10.02.2025, “Për miratimin e kriterëve të pranimit në programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026 – 2027”;
4. Vendimin e Senatit Akademik Nr. 05, datë 10.02.2025, “Për miratimin e kriterëve të pranimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026 – 2027”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 459 Prot.

Tiranë, më 10/02/2025

V E N D I M

Nr. 02, datë 10.02.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026, I PËRDITËSUAR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, të përditësuara, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, të përditësuara, për vitin akademik 2025-2026, në programet e ciklit të parë të studimit, Bachelor, dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në UPT, për vitin akademik 2025 – 2026, të përditësuara.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, kriteret e pranimit të ofruara nga fakultetet e UPT-së për vitin akademik 2025-2026, janë si më poshtë:

A.

1. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Mekanike
2. Bachelor në Inxhinieri Materiale
3. Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode
4. Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike
2. Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare
3. Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
5. Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

3. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:


1. Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
2. Bachelor në Inxhinierinë Hidroteknike
3. Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinierinë Matematike
2. Bachelor në Inxhinierinë Fizike
3. Bachelor në Inxhinieri Kimike

kanë vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.

- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}} + 0.1 * \text{Mes}_{\text{Kimi}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes_{VKM} , nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

$\text{Mes}_{\text{Matematike}}$, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{\text{Fizike}}$, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

Mes_{Kimi} , nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$K_{\text{koef. Shkollës}}$, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.

B.

1. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektronike
2. Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve
3. Bachelor në Inxhinieri Informatike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Ku:

Mes(vkm), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.

C.

1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim i Industrisë
2. Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{vkm}} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes(vkm), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Për programin e studimit:

3. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Energjitikë

janë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.5 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.5(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes_(VKM), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes_(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes_(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

D.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës me programet e integruara të studimit të ciklit të dytë:


1. Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt
2. Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist

dhe programin e studimit të ciklit të parë:

1. Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.

- Kandidatët do t'i nënshtrohen një testi në hyrje të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës.

$$0.4 * Mes(v_{KM}) * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.6 * T_{(Testi)} * 100$$

$Mes(v_{KM})$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5; $K_{koef. Shkollës}$, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2025 – 2026.

$T_{(Testi)}$, do të quajmë rezultatin e testit që do të organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës i cili synon vlerësimin e njohurive në degët specifike të studimit, i përbërë nga katër komponent, si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------|
| • Test i arsytimit logjik | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i kulturës së përgjithshme | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i historisë dhe historisë së arkitekturës | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i vizatimit dhe prezantimit | 25% $T_{(Testi)}$ |

Konkursi do të jetë i organizuar në nivel Fakulteti dhe do të zhvillohet në një ditë të vetme. Përgjigjet e pyetjeve do të jenë me përzgjedhjen e alternativës së saktë, në mënyrë që të mundësoj korrigjimin elektronik.

Kriteret dhe mënyra e organizimit të testit të pranimit do të bëhet në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe rregullores së testimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 460 Prot.

Tiranë, më 10 /02 /2025

V E N D I M

Nr. 03, datë 10.02.2025

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026, I PËRDITËSUAR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, të përditësuara, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, të përditësuara, për vitin akademik 2025-2026, në programet e ciklit të dytë të studimit, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

**Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë në UPT,
për vitin akademik 2025 – 2026, të përditësuara.**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë, kriteret e pranimit të ofruara nga fakultetet e UPT-së për vitin akademik 2025-2026, janë si më poshtë;

A. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për të gjithë programet e studimit të ciklit të dytë, ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidatët duhet të kenë diplomë Bachelor, prioritet kanë kandidatët që kanë diplomë Bachelor në FIM.
2. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor
3. Preferenca për programin e përzgjedhur nga kandidati.

B. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave me programet e studimit:

- Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi;
- Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;
- Master i Shkencave në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure;
- Master i Shkencave në Inxhinieri e Gjeomjedisit;

ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidati duhet të ketë një diplomë Bachelor të marrë në UPT ose ekuivalente;
2. Kandidati duhet të njohë njërën prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian, si anglisht / frëngjisht / gjermanisht / italisht / spanjisht, të vërtetuara me dëshmi sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

3. Plotësojnë kriterin e notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, e cila propozohet çdo vit nga departamentet përkatëse dhe miratohet nga dekanati i fakultetit mbi bazën e numrit të studentëve dhe rezultateve të arritura prej tyre.

Me programet e studimit:

- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Gjeomatikë;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e vendburimeve të hidrokarbureve;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeomjedisi.**

ka vendosur këto kritere:

1. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, që ka të njëjtin emërtim me programin të studimit në nivelin Master Profesional;
2. Nëse pas kriterit të përcaktuar në pikën "I." ka ende kuota të lira, regjistrimet vazhdojnë sipas renditjes së bërë me mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor të marrë në FGJM, por duke marrë në konsideratë shkallën e afërsisë me programin e studimit Master Profesional ku aplikojnë këta kandidatë.
3. Nëse pas kriterit të përcaktuar në pikat i. dhe ii. ka ende kuota të lira, regjistrimet vazhdojnë sipas renditjes së bërë me mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor në UPT ose jashtë tij.

C. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e transportit;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë;**





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këto programe studimi kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) në fushën e studimit ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
2. Kriter pranimi në këto programe studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Me programet e studimit:

- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këto programe studimit kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programit përkatës të studimit të ciklit të parë.
2. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

D. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

2. Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike*, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Matematike;*
 - Nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Matematike, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja*
 - b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë "*Bachelor*" ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja.*

Plotësimi me njohuritë bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

3. Kriter pranimi në këtë program studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2025-2026, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

• **Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi, kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Në studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e ciklit të parë nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:*
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Fizikë, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja*
 - b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me këtë rregullore të programit të studimit.

3. Kriter pranimi në këtë program studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2025-2026, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinier Fizike;**

Ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi, kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike*, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Fizike;*
 - nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Fizikë, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

- *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja*
- b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikula dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me këtë rregullore të programit të studimit.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “*Master i shkencave*” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2025-2026, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

• **Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemesh;**

Në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që:

1. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
2. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh, pranohen:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

- a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë **Bachelor** (ose Diplomë e Niveli të Parë) në Inxhinieri Matematike.
- b) **me plotësim të njohurive**, studentë që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë “Bachelor” (ose Diplomë e Niveli të Parë) në:
 - Inxhinieri Fizike (FIMIF, UPT)
 - Inxhinieri Elektrike (FIE të tre drejtimet, UPT)
 - Inxhinieri Elektronike (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Informatike (FTI, UPT)
 - Inxhinierine e Telekomunikacionit (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Gjeoinformatikë (FGJM, UPT)
 - Fizikë (FSHN, UT)
 - Matematikë (FSHN, UT)

4. Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë: “Bachelor” ose Diplomë e Niveli të Parë nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:

- Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;
- Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve shqiptare;
- Bachelor në disa fakultete të universiteteve publike apo private me drejtim në fusha të përafërta
- Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve të huaja.

Plotësimi me njohuritë formuese bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

5. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin akademik 2025-2026, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

E. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike;**

ka vendosur këto kritere;





REPUBLIKA E SHQIPERISE




UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

1. Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
2. Gjithashtu mund të aplikojnë kandidatet që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në fushat e teknologjise se informacionit, te shkencave te natyres, inxhinierise ekonomike, menaxhimit inxhinierik, informatikes ekonomike, sigurise apo krimet kibernetik, si dhe shkenca te tjera te ngjashme.
3. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
4. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë testime paraprake/pranuese për kandidatet për studimet Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike si dhe intervista. Përparësi do të kenë për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë pune në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Rregjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët;
2. Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët;
3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Elektronike) të fituar në UPT ose jashtë saj, si dhe studentet sipas përcaktimit të pikës





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

II, bazuar ne mesataren e ponderuar të diplomës Bachelor, e cila preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët duhet të zotërojnë Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike ose Inxhinieri Telekomunikacioni , Inxhinieri Elektronike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga Departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
2. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me gjashtë pikë pesë (≥ 6.50).
2. Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për këto diploma duhet të jetë më e madhe ose barabartë me shtatë (≥ 7.00).
3. Renditen te tretët në vijim të pikës së 2-të të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.00).
4. Renditen pas pikës 3, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më të vogël se gjashtë pikë pesë (< 6.50).

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni;**

ka vendosur këto kritere:





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

1. Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MASH, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambjentet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
2. Gjithashtu mund të aplikojnë për regjistrim në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni kandidatet që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në fushat e teknologjise se informacionit, te shkencave te natyres, inxhinierise ekonomike, menaxhimit inxhinierik, informatikes ekonomike, sigurise apo krimet kibernetik, si dhe shkenca te tjera te ngjashme.
3. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
4. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë teste paraprake/pranuese për kandidatet për studimet Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni si dhe intervista. Përparsi do të kene për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë punë në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Elektronike, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët.
2. Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët.
3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

Telekomunikacion) të fituar në UPT ose jashtë saj, si dhe studentet sipas përcaktimit të pikës II, bazuar në mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, e cila preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

• Programi i përbashkët i studimit Master i Shkencave në Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim

Ka vendosur këto kritere:

1. Lejohen të ndjekin këtë program studimi ata kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Informatike, në Inxhinieri Elektronike, në Inxhinieri Telekomunikacioni, në FTI, ose kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në fushën e Teknologjisë së Informacionit apo të ngjashme, të fituar jashtë FTI.
2. Për kandidatë, të cilët janë diplomuar jashtë vendit duhet të bëjnë njësimin e diplomës në ministrinë përgjegjëse në rast regjistrimi në këtë program studimi.

Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nga vlerësimi i dosjes së aplikimit e cila duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

- Letër motivimi
- Fotokopje të noterizuar të kartonit të diplomës së bashku me suplementin e diplomës (mesatare e ponderuar ≥ 8 për studentet e FTI, dhe ≥ 9 për studentet jashtë FTI)
- Fotokopje të noterizuar e mbrojtjes së gjuhës angleze (niveli minimal B1)
- Fotokopje të noterizuar të dëftesës së shkollës së mesme së bashku me listën e notave.
- Fotokopje të kartës së identitetit
- 2 fotografi
- Njohuri të gjuhës franceze janë të mirëpritura (por jo të detyrueshme)

Komisioni Ad-Hoc në bashkëpunim me përfaqësuesit e UTC merr në shqyrtim dosjet e kandidatëve, ku prioritet kanë kandidatë që zotërojnë një diplomë Bachelor në FTI. Janë 25 kuota të paracaktuara në kuadrin e bashkëpunimit midis UPT dhe UTC si dhe të miratuara nga MAS. Pranimi përfundimtar kërkon miratimin e institucionit partner dhe pranimit në programin e diplomës që i korrespondon.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.0).
2. Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni pranë FTI UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për këto diploma duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.00).





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

3. Renditen pas pikës 2, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë pike pesë (≥ 9.50).
4. Renditen pas pikës 3, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me tetë (≥ 8.0).
5. Renditen pas pikës 4, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni pranë FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me tetë (≥ 8.0).
6. Renditen pas pikës 5, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.0).


- **Master Profesional në Inxhinieri Software;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët duhet të zotërojnë Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti. Në raste specifike, të kërkuar nga komisioni Ad-Hoc, aplikantët me diplome jashtë FTI do t'i nënshtrohen një interviste verbale ne prani të komisionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
2. Regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët e FTI që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni.
3. Regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar në UPT të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.
4. Regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar jashtë UPT, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

• **Master Profesional në Teknologji Informacioni;**

ka vendosur këto kritere:

1. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor dhe nenligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti;
2. Gjithashtu mund të aplikojnë për regjistrim në programin e studimit Master Profesional në Teknologji Informacioni kandidatet që kanë përfunduar kryesisht studimet e ciklit të parë në fushat e inxhinierise, në fushat e teknologjise se informacionit, art-media-design, në fushat e shkencave të natyres, të shkencave humane apo atyre social-ekonomike, administrimit, menaxhimit apo jurisprudences me orientim kriminel kibernetik.
3. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë testime paraprake/pranuese për kandidatet për studimet Master Profesional në Teknologji Informacioni, si dhe intervista. Përparësi do të kenë për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë punë në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
2. N.q.s. pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, kandidatet që i perkasin Pikes I, Neni 9 (kandidatet që zoterojnë diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj).
3. N.q.s. pas plotësimit të Pikës I, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët që i perkasin Pikes II, Neni 9, sipas diplomës Bachelor të fituar, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vleresimeve të komisionit ad hoc të ngritur nga DET.
4. N.q.s. edhe pas plotësimit të Pikës II, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim kandidatë sipas percaktimeve të Pikes III të Nenit 9, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vleresimeve të komisionit ad hoc të ngritur nga DET.

F. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët duhet të kenë një diplomë Bachelor në UPT, por prioritet kanë kandidatët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranoen kandidatë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit
2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin 80/2015, neni 76, pika 4 dhe pika 5.
3. Kandidatët duhet të kenë mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor jo më pak se 6.5.
4. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.
5. Nëse nuk plotësohet numri minimal i studentëve për hapjen e programit të studimit, mesatarja e ponderuar ulet poshtë 6.5

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Energjetikë;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët që aplikojnë në këtë program studimi duhet të kenë përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Elektrike me notën mesatare të ponderuar jo më pak se 7 (shtate);
2. Kriteret e përcaktuara në nenin 76/4 dhe në nenin 76/5 të Ligjit Nr. 80/2015;
3. Renditja e aplikanteve bëhet sipas përputhshmërisë me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike drejtimi Energjetikë dhe sipas notës mesatare të ponderuar;
4. Mund të pranohen studente nga programe studimi në Inxhinieri Elektrike nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, të akredituara, kur pas procesit të ekuivalentimit, përputhshmëria me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike drejtimi Energjetikë është jo më pak se 150 kredite;
5. Nëse nuk plotësohet numri minimal për hapjen e programit, mesatarja pranohet më e ulët sipas renditjes së kandidatëve në përputhje me Vendimin e Dekanatit.

- **Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim Industri;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët që aplikojnë në këto programe studimi duhet të kenë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranoen kandidatë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
2. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.
3. Kandidatët që kanë diplomë me të njëjtin emërtim, diploma që mbështeten nga Departamenti i Automatikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultete të tjera të UPT-së, kanë prioritet në renditje.





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

• **Master Profesional në Elektroenergjitikë;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët që aplikojnë në këtë program studimi duhet të kenë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranohen kandidatë nga programe studimi ekuivalente nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit të akredituara.
2. Renditja e kandidatëve bëhet sipas përputhshmërisë me programin e studimeve Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili Energjitikë dhe notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.

G. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për programin e studimit:

• **Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture:**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi do të pranohen kandidatët të cilët kanë:
 - Diplomë në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në Arkitekturë,
 - Diplomë në programin e ciklit të parë të studimeve në Arkitekturë dhe/ose të Ciklit të Dytë, në Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi duke i dhënë prioritet në regjistrim, kandidatëve të diplomuar në UPT, përkatësisht në:
 - Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
 - Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
2. Kandidatët e diplomuar jashtë vendit duhet të bëjnë njehsimin e diplomës sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Renditja e kandidatëve do të bëhet në rend zbritës, në bazë të mesatares më të lartë të notave, sipas kategorive të kuotave të miratuara.
4. Procedura e pranimit, do t'i përmbahet udhëzimeve të MAS dhe Rregullores së Programit të Ciklit të Dytë të Studimit, Master Profesional, në Restaurim Monumenesh Kulture.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 461 Prot.

Tiranë, më 10/02/2025

V E N D I M

Nr. 04, datë 10.02.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2026 - 2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2026-2027, në programet e ciklit të parë të studimit, Bachelor, dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, si më poshtë:
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në UPT, për vitin akademik 2026 – 2027

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, kriteret e pranimit të ofruara nga fakultetet e UPT-së për vitin akademik 2026-2027, janë si më poshtë:

A.

1. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Mekanike
2. Bachelor në Inxhinieri Materiale
3. Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode
4. Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike
2. Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare
3. Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
5. Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

3. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:


1. Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
2. Bachelor në Inxhinierinë Hidroteknike
3. Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinierinë Matematike
2. Bachelor në Inxhinierinë Fizike
3. Bachelor në Inxhinieri Kimike

kanë vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim” i ndryshuar, në





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.

- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{(\text{VKM})} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{(\text{Matematike})} + 0.4 * \text{Mes}_{(\text{Fizike})} + 0.1 * \text{Mes}_{(\text{Kimi})})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

$\text{Mes}_{(\text{VKM})}$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

$\text{Mes}_{(\text{Matematike})}$, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{(\text{Fizike})}$, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{(\text{Kimi})}$, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$K_{\text{koef. Shkollës}}$, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2026 – 2027.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.

B.

1. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektronike
2. Bachelor në Inxhinieri të Telekomunikacioneve
3. Bachelor në Inxhinieri Informatike

kanë vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Ku:

Mes(vkm), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2026 – 2027.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas kriterit të mësipërm dhe kuotat e pranimit të përcaktuara për çdo program studimi.

C.

1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim i Industrisë
2. Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{\text{vkm}} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

Mes(vkm), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2026 – 2027.





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Për programin e studimit:

3. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Energjitikë

janë vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.5 * \text{Mes}_{\text{VKM}} + 0.5(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

$\text{Mes}_{\text{(VKM)}}$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5;

$\text{Mes}_{\text{(Matematike)}}$, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

$\text{Mes}_{\text{(Fizike)}}$, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

$K_{\text{koef. Shkollës}}$, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2026 – 2027.

D.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës me programet e integruara të studimit të ciklit të dytë:

1. Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt
2. Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist

dhe programin e studimit të ciklit të parë:

1. Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar, në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, neni 74, pika 1.

- Kandidatët do t’i nënshtrohen një testi në hyrje të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës.

$$0.4 * Mes_{(VKM)} * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.6 * T_{(Testi)} * 100$$

$Mes_{(VKM)}$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 3.6.2020, i ndryshuar pika 5; $K_{koef. Shkollës}$, koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2026 – 2027.

$T_{(Testi)}$, do të quajmë rezultatin e testit që do të organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës i cili synon vlerësimin e njohurive në degët specifike të studimit, i përbërë nga katër komponent, si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------|
| • Test i arsytimit logjik | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i kulturës së përgjithshme | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i historisë dhe historisë së arkitekturës | 25% $T_{(Testi)}$ |
| • Test i vizatimit dhe prezantimit | 25% $T_{(Testi)}$ |

Konkursi do të jetë i organizuar në nivel Fakulteti dhe do të zhvillohet në një ditë të vetme. Përgjigjet e pyetjeve do të jenë me përzgjedhjen e alternativës së saktë, në mënyrë që të mundësoj korrigjimin elektronik.

Kriteret dhe mënyra e organizimit të testit të pranimit do të bëhet në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe rregullores së testimit.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 462 Prot.

Tiranë, më 10/02/2025

V E N D I M

Nr. 05, datë 10.02.2025

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2026 - 2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2026-2027, në programet e ciklit të dytë të studimit, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë në UPT,
për vitin akademik 2026 – 2027

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë, kriteret e pranimit të ofruara nga fakultetet e UPT-së për vitin akademik 2026-2027, janë si më poshtë;

A. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për të gjithë programet e studimit të ciklit të dytë, ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidatët duhet të kenë diplomë Bachelor, prioritet kanë kandidatët që kanë diplomë Bachelor në FIM.
2. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor
3. Preferenca për programin e përzgjedhur nga kandidati.

B. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogeologji;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri e Gjeomjedisit;**

ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidati duhet të ketë një diplomë Bachelor të marrë në UPT ose ekuivalente;
2. Kandidati duhet të njohë njërën prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian, si anglisht / frëngjisht / gjermanisht / italisht / spanjisht, e vërtetuar me dëshmi sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
3. Plotësojnë kriterin e notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, e cila propozohet çdo vit nga departamentet përkatëse dhe miratohet nga dekanati i fakultetit mbi bazën e numrit të studentëve dhe rezultateve të arritura prej tyre.





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Me programet e studimit:

- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Gjeomatikë;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve;**
- **Master Profesional në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogeologji;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e vendburimeve të hidrokarbureve;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeomjedisi.**

ka vendosur këto kritere:

1. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, që ka të njëjtin emërtim me programin të studimit në nivelin Master Profesional;
2. Nëse pas kriterit të përcaktuar në pikën "I." ka ende kuota të lira, regjistrimet vazhdojnë sipas renditjes së bërë me mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor të marrë në FGJM, por duke marrë në konsideratë shkallën e afërsisë me programin e studimit Master Profesional ku aplikojnë këta kandidatë.
3. Nëse pas kriterit të përcaktuar në pikat i. dhe ii. ka ende kuota të lira, regjistrimet vazhdojnë sipas renditjes së bërë me mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor në UPT ose jashtë tij.

C. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Gjeoteknikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Infrastrukturë e transportit;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Trajtim Uji;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi;**

ka vendosur këto kritere:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

1. Në këto programe studimi kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) në fushën e studimit ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
2. Kriter pranimi në këto programe studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT, në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Me programet e studimit:

- **Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike;**
- **Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këto programe studimit kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (Bachelor) në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, të cilat mund të jenë fituar brenda ose jashtë vendit. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta duhet të kenë jo më pak se 85% përputhshmëri të programit përkatës të studimit të ciklit të parë.
2. Në çdo rast pranimi, kandidati i diplomuar jashtë vendit duhet të ketë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

D. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike;**

ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.


2. Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike*, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Matematike;*
 - Nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Matematike, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja*
 - b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë "*Bachelor*" ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike të universiteteve të huaja.*

Plotësimi me njohuritë bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.

3. Kriter pranimi në këtë program studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2026-2027, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor;**

ka vendosur këto kritere:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

1. Në këtë program studimi, kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Në studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e ciklit të parë nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:*
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Fizikë, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja*
 - b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me këtë rregullore të programit të studimit.





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

3. Kriter pranimi në këtë program studimi, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2026-2027, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinier Fizike;**

Ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi, kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përfaqëta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike*, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - *Bachelor në Inxhinieri Fizike;*
 - *Diplomë e Niveli të Parë në Inxhinieri Fizike;*
 - nga fusha të njëjta ose të përfaqëta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
 - *Bachelor në Inxhinieri Matematike, FIMIF-UPT*
 - *Bachelor në Fizikë, FSHN, UT*
 - *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja*





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

- b) **me plotësim të njohurive**, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
- *Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve shqiptare;*
 - *Bachelor në disa fakultetet inxhinierike, fakultete të shkencave të natyrës të universiteteve të huaja.*

Plotësimi i njohuritë formuese bëhen në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikula dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me këtë rregullore të programit të studimit.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “*Master i shkencave*” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin 2026-2027, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

• **Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemesh;**

Në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë, kandidatët që:

1. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
2. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh, pranohen:
 - a) **pa njohuri plotësuese**, studentët që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë *Bachelor* (ose Diplomë e Niveli të Parë) në Inxhinieri Matematike;
 - b) **me plotësim të njohurive**, studentë që kanë marrë Diplomë Universitare të ciklit të parë “*Bachelor*” (ose Diplomë e Niveli të Parë) në:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK


- Inxhinieri Fizike (FIMIF, UPT)
 - Inxhinieri Elektrike (FIE të tre drejtimet, UPT)
 - Inxhinieri Elektronike (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Informatike (FTI, UPT)
 - Inxhinierine e Telekomunikacionit (FTI, UPT)
 - Inxhinieri Gjeoinformatikë (FGJM, UPT)
 - Fizikë (FSHN, UT)
 - Matematikë (FSHN, UT)
4. Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë: “Bachelor” ose Diplomë e Niveli të Parë nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, ku përfshihen diplomat:
- Bachelor në disa fakultete inxhinierike të UPT-së;
 - Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve shqiptare;
 - Bachelor në disa fakultete të universiteteve publike apo private me drejtim në fusha të përafërta
 - Bachelor në disa fakultete inxhinierike të universiteteve të huaja.
- Plotësimi me njohuritë formuese bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT-së dhe me rregulloren e programit të studimit.
5. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara për vitin akademik 2026-2027, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë.

E. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike;**

ka vendosur këto kritere;

1. Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;

2. Gjithashtu mund të aplikojnë kandidatet që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në fushat e teknologjise se informacionit, te shkencave te natyres, inxhinierise ekonomike, menaxhimit inxhinierik, informatikes ekonomike, sigurise apo krimet kibernetik, si dhe shkenca te tjera te ngjashme.
3. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
4. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund te organizoje testime paraprake/pranuese per kandidatet per studimet Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike si dhe intervista. Perparesi do te kene per t' u regjistruar gjithashtu edhe te gjithë ata candidate qe punojne apo kane eksperienca pune ne tregun/industrine e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Rregjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët;
2. Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët;
3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Elektronike) të fituar në UPT ose jashtë saj, si dhe studentet sipas përcaktimit te pikes II, bazuar ne mesataren e ponderuar të diplomës Bachelor, e cila preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

• **Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike;**

ka vendosur këto kritere:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

1. Kandidatët duhet të zotërojnë Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike ose Inxhinieri Telekomunikacioni , Inxhinieri Elektronike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga Departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MAS, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambientet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;
2. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.


Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me gjashtë pikë pesë (≥ 6.50).
2. Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për këto diploma duhet të jetë më e madhe ose barabartë me shtatë (≥ 7.00).
3. Renditen të tretët në vijim të pikës së 2-të të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.00).
4. Renditen pas pikës 3, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më të vogël se gjashtë pikë pesë (< 6.50).

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni;**

ka vendosur këto kritere:

1. Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MASH, parimit të meritës dhe





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambjentet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;

2. Gjithashtu mund të aplikojnë për regjistrim në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni kandidatet që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në fushat e teknologjise se informacionit, te shkencave te natyres, inxhinierise ekonomike, menaxhimit inxhinierik, informatikes ekonomike, sigurise apo krimet kibernetik, si dhe shkencat tjera te ngjashme.
3. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
4. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë testime paraprake/pranuese për kandidatet për studimet Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni si dhe intervista. Përparsi do të ketë për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë pune në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Elektronike, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët.
 2. Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh) me mesatare më të ulët;
 3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Telekomunikacion) të fituar në UPT ose jashtë saj, si dhe studentet sipas përcaktimit të pikës II, bazuar në mesataren e ponderuar të diplomës Bachelor, e cila preferohet të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).
- **Programi i përbashkët i studimit Master i Shkencave në Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim**





REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

Ka vendosur këto kritere:

1. Lejohen të ndjekin këtë program studimi ata kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Informatike, në Inxhinieri Elektronike, në Inxhinieri Telekomunikacioni, në FTI, ose kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në fushën e Teknologjisë së Informacionit apo të ngjashme, të fituar jashtë FTI.
2. Për kandidatë, të cilët janë diplomuar jashtë vendit duhet të bëjnë njësimin e diplomës në ministrinë përgjegjëse në rast regjistrimi në këtë program studimi.

Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nga vlerësimi i dosjes së aplikimit e cila duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

- Letër motivimi
- Fotokopje të noterizuar të kartonit të diplomës së bashku me suplementin e diplomës (mesatare e ponderuar ≥ 8 për studentet e FTI, dhe ≥ 9 për studentet jashtë FTI)
- Fotokopje të noterizuar e mbrojtjes së gjuhës angleze (niveli minimal B1)
- Fotokopje të noterizuar të dëftesës së shkollës së mesme së bashku me listën e notave.
- Fotokopje të kartës së identitetit
- 2 fotografi
- Njohuri të gjuhës franceze janë të mirëpritura (por jo të detyrueshme)

Komisioni Ad-Hoc në bashkëpunim me përfaqësuesit e UTC merr në shqyrtim dosjet e kandidatëve, ku prioritet kanë kandidatë që zotërojnë një diplomë Bachelor në FTI. Janë 25 kuota të paracaktuara në kuadrin e bashkëpunimit midis UPT dhe UTC si dhe të miratuara nga MAS. Pranimi përfundimtar kërkon miratimin e institucionit partner dhe pranimit në programin e diplomës që i korrespondon.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Renditen fillimisht, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.0).
2. Renditen të dytët në vijim të pikës 1, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni pranë FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për këto diploma duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.00).
3. Renditen pas pikës 2, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë pike pesë (≥ 9.50).





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

4. Renditen pas pikës 3, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë DII-FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me tetë (≥ 8.0).
5. Renditen pas pikës 4, sipas kërkesave/preferencave sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni pranë FTI, UPT me notë mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor më e madhe ose barabartë me tetë (≥ 8.0).
6. Renditen pas pikës 5, të gjithë studentët që zotërojnë diplomë Bachelor ose ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Informatike të fituar në UPT ose jashtë saj, ku mesatarja e ponderuar të diplomës Bachelor duhet të jetë më e madhe ose barabartë me nëntë (≥ 9.0).

- **Master Profesional në Inxhinieri Software;**

ka vendosur këto kritere:

1. Kandidatët duhet të zotërojnë Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti. Në raste specifike, të kërkuar nga komisioni Ad-Hoc, aplikantët me diplome jashtë FTI do t'i nënshtrohen një interviste verbale ne prani të komisionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
2. Regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët e FTI që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni.
3. Regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar në UPT të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.
4. Regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor të fituar jashtë UPT, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

- **Master Profesional në Teknologji Informacioni;**

ka vendosur këto kritere:

1. Diplomë të Ciklit të Parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor dhe nenligjor në fuqi) në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike,





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

- të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet ad hoc që ngrihen nga departamenti;
2. Gjithashtu mund të aplikojnë për regjistrim në programin e studimit Master Profesional në Teknologji Informacioni kandidatet që kanë përfunduar kryesisht studimet e ciklit të parë në fushat e inxhinierise, në fushat e teknologjise se informacionit, art-media-design, në fushat e shkencave të natyres, të shkencave humane apo atyre social-ekonomike, administrimit, menaxhimit apo jurisprudences me orientim kriminel kibernetik.
 3. Varesisht nga diploma bachelor, DET (FTI-UPT) mund të organizojë testime paraprake/pranuese për kandidatet për studimet Master Profesional në Teknologji Informacioni, si dhe intervista. Përparësi do të kenë për t' u regjistruar gjithashtu edhe të gjithë ata kandidatë që punojnë apo kanë eksperiencë pune në tregun/industrinë e komunikimeve elektronike dhe/ose teknologjise se informacionit.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT.
2. N.q.s. pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Inxhinieri Informatike, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, kandidatet që i perkasin Pikes I, Neni 9 (kandidatet që zoterojnë diploma të ngjashme të fituara në UPT ose jashtë saj).
3. N.q.s. pas plotësimit të Pikës I, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët që i perkasin Pikes II, Neni 9, sipas diplomës Bachelor të fituar, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vleresimeve të komisionit ad-hoc të ngritur nga DET.
4. N.q.s. edhe pas plotësimit të Pikës II, të Nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim kandidatë sipas percaktimeve të Pikes III të Nenit 9, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor dhe vleresimeve të komisionit ad-hoc të ngritur nga DET.

F. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë;**
- **Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike;**

ka vendosur këto kritere:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

1. Kandidatët duhet të kenë një diplomë Bachelor në UPT, por prioritet kanë kandidatët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranohen kandidatë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit
2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin 80/2015, neni 76, pika 4 dhe pika 5.
3. Kandidatët duhet të kenë mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor jo më pak se 6.5.
4. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.
5. Nëse nuk plotësohet numri minimal i studentëve për hapjen e programit të studimit, mesatarja e ponderuar ulet poshtë 6.5

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Energjetikë;**

ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidatët që aplikojnë në këtë program studimi duhet të kenë përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Elektrike me notën mesatare të ponderuar jo më pak se 7 (shtate);
2. Kriteret e përcaktuara në nenin 76/4 dhe në nenin 76/5 të Ligjit Nr. 80/2015;
3. Renditja e aplikanteve bëhet sipas përputhshmërisë me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike drejtimi Energjetikë dhe sipas notes mesatare të ponderuar;
4. Mund të pranohen studente nga programe studimi në Inxhinieri Elektrike nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, të akredituara, kur pas procesit të ekuivalentimit, përputhshmëria me programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike drejtimi Energjetikë është jo më pak se 150 kredite;
5. Nëse nuk plotësohet numri minimal për hapjen e programit, mesatarja pranohet më e ulët sipas renditjes së kandidatëve në përputhje me Vendimin e Dekanatit.

- **Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim Industrie;**

- **Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike;**

ka vendosur këto kriteret:

1. Kandidatët që aplikojnë në këto programe studimi duhet të kenë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranohen kandidatë nga programe studimi ekuivalente në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
2. Renditja e kandidatëve bëhet sipas notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.
3. Kandidatët që kanë diplomë me të njëjtin emërtim, diploma që mbështeten nga Departamenti i Automatikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultete të tjera të UPT-së, kanë prioritet në renditje.

- **Master Profesional në Elektroenergjetikë;**

ka vendosur këto kriteret:





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

1. Kandidatët që aplikojnë në këtë program studimi duhet të kenë diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Pranohen kandidatë nga programe studimi ekuivalente nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit të akredituara.
2. Renditja e kandidatëve bëhet sipas përputhshmërisë me programin e studimeve Bachelor në Inxhinieri Elektrike profili Energjitikë dhe notës mesatare të ponderuar të studimeve Bachelor.

G. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për programin e studimit:

• Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture:

ka vendosur këto kritere:

1. Në këtë program studimi do të pranohen kandidatët të cilët kanë:
 - Diplomë në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në Arkitekturë,
 - Diplomë në programin e ciklit të parë të studimeve në Arkitekturë dhe/ose të Ciklit të Dytë, në Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi duke i dhënë prioritet në regjistrim, kandidatëve të diplomuar në UPT, përkatësisht në:
 - Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
 - Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
2. Kandidatët e diplomuar jashtë vendit duhet të bëjnë njehsimin e diplomës sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Renditja e kandidatëve do të bëhet në rend zbritës, në bazë të mesatares më të lartë të notave, sipas kategorive të kuotave të miratuara.
4. Procedura e pranimit, do t'i përmbahet udhëzimeve të MAS dhe Rregullores së Programit të Ciklit të Dytë të Studimit, Master Profesional, në Restaurim Monumenesh Kulture.

